1307
215/1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURES DHE ENERGJISË
AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE
DREJTORIA E MONITORIMIT TË HIDROCENTRALEVE

Nr. 9378/1 Prot. Tiranë, më 28.12.2018

Lënda: Mbi kërkesën për informacion

QËNDRËS "RES PUBLICA"
Adresa: Blv "Gjergj Fishta", Nd.24, H.3, Ap.44
Tiranë

Në përgjigje të shkresës me Nr.215/18 Prot, datë 22.10.2018 dhe Nr.9378 Prot Hyrës AKBN., datë 06.12.2018 në lidhje me kërkesën nga Qendra "Res Publica", ju sqarojmë si më poshtë vijon:

1. *Në lidhje me pikën e parë*, ju bëjme me dije se, procedura për dhënien/lidhjen e kontratave koncesionare është kompetencë e Ministrise së Infrastrukturës dhe Energjisë.

2. *Në lidhjen me pikën e dytë*, një kopje të plotë të kontratës koncesionare mund ta merrni në faqen zyrtare të Agjensisë së Trajtimit të Koncesioneve **http://www.atrako.gov.al/.**

3. *Në lidhje me pikën e tretë*, pranë AKBN është dorëzuar projekti i zbatimi të HEC-eve "Kaskada Shushicë", projekt i i cili është vlerësuar nga Grupi i Oponencës Teknike dhe eshtë dërguar pranë MIE.

Nuk kemi informacion nësë ky projekt zbatimi është miratuar nga Autoriteti Kontraktor (MIE).

Thekojmë se, në Kontratat koncesionare për hidrocentralet, sipas nenit 27, përcaktohet se "Secila nga palët duhet të konsiderojë konfidenciale të gjitha dokumentat dhe informacionet e tjera në lidhje me projektin, qofshin këto tregtare apo teknike dhe nuk mund tja bëjë të ditura një pale të tretë, të gjitha apo një pjesë të dokumentit apo informacionit, pa miratimin e palës tjetër, perveç se për qëllimin e permbushjes së kushteve të kësaj kontrate.

Bazaur në VKM Nr. 547 datë 09.08.2006 "Për krijimin e Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore" përcakton se AKBN "Monitoron Kontratat Koncesionare" por nuk është palë në

lidhjen e këtyre kontratave. Në këtë rast palë në kontratë (autoriteti kontraktor) është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Për sa më sipër Qendra "Res Publica" mund ti drejtohet MIE-es për informacionin të mëtejshëm.

DREJTOR EKZEKUTIV

Adrian BYLYKU